

E DIELA E BARDHE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe dy të Triodit, dyke përsëritur të parën:

PAS OLIN APOTHEMENI, T. T. II

Krijetari Zoti im, mori ca pluhër prej dheut, dhe me fryrje shpirt më dha, dhe njeri të gjallë më bëri dhe më nderoj, përmi dhe si kryetar, mi të gjitha gjërat, si vëlla dhe shok të Engjëve, po Satani gjarpëri, më largoj nga Zoti dinakërisht, me grackën e të ngrënave, dhe më nxori jashtë nga qielli. Ti q' u-mishërove, prej Nënës Virgjërëshë ti më thirr, dhe në Parajsën e Engjëjve, prapë më vëndos me nder.

Robën që më dhe o Zot, e humba unë i mjeri, kur ta shkela urdhërin, dhe rëmbeva mollën nga dor' e gjarpërit; dhe tani me flet' e fik, edhe me lëkurë, varfërisht i veshur jam si rob, po punonj dhe po dërsinj, për të ngrënë bukën plot me mundim; dhe toka që lëronj me lot, gjëmbe po më sjell e mallkuara. Ti q' u-mishërove prej Nënës Virgjërëshë ti më thirr, dhe në Parajsën e Engjëjve, prapë më vëndos me nder.

LAVDI, T. T. II. Adami qëndroj, i çveshur përjashta Parajës, dhe qante dhe vajtonte. Mjeri unë, që u-gënjeva prej të paudhit, edhe e humba lavdinë. Mjeri unë, që isha i lumur, dhe tani jam i syrgjynosur! Nukë do të gëzonj më ty o Parajsë; nukë do të shikonj më ty o Zot, o Perëndi dhe Krijetari im; se do të këthehem në

dhenë, prej të cilit më ke marrë. Pra të thërres o Zot i zëmërdhëmpshur, kij mëshirë për mua mëkatarin.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T. T. II. Adami u-dhua prej Parajsës, nga shkaku i së ngrënës, dhe qëndroj përjashta, dhe qante dhe vajtonte: Mjeri unë, ç' është kjo e zezë që pësova! Shkela një porrosi të Zotit, edhe i humba të gjitha të mirat. O Parajsë e Shenjtë, që u-mbolle për mua, dhe u-mbylle prej Evës, lutui Perëndisë, të më gëzonjë përsëri me lulet e tua. Përandaj Shpëtimtari i tha: Nukë dua t'i humbas krijesat, po dua t'i shpëtonj, dhe tua mësonj të vërtetën, dhe nukë do t'i nxier jashtë, ata që vijnë pranë maje.

Tania e Tingëllit, edhe Përlëshoret e Tingëllit.

SHKURTORJA, T. T. II.

Ti që prin me urtësi, ti që fal çdo dituri, dhe mundon të çmëndurit, edhe mpron të varfërit, ndrit-ma dhe forco-ma zëmërën o Zoti Krisht, ti dhuro-ma fjalën, o Fjal' e Perëndisë, që të thërres me zë të math: Kij mëshirë për mua mëkatarin, o Perëndi mëshirëplot.

SHTEPIA

Qëndroj Adami një kohë, dhe qante përjashta Parajsës, dhe rrihte krahërorin me duar dhe thoshte: Kij mëshirë për mua mëkatarin, o Perëndi mëshirëplot.

SINAKSARI

Gjithë sot, kujtojmë dbimin e Adamit të Parëgatuuar nga gëzimet e Parajsës.

Me dhëmpshërinë e patreguar, o Krisht o Perëndi, vlerësona për gëzimet e Parajsës, dhe mëshirona si i vetëm njeridashës.

*Zbritësoret e Publikanit: "E kapërceu më këmbë."
Pas Dërgimësore Ngjallësore këndohen:*

DERGIMESORET, T.II. PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Ta shkela porrosin' o Zot, un i mjeri pa ditur, humba lavdin' e qiellit, dhe në turpin u-mbyta, dhe nga gëzim' i Parajsës, u-largova për jetë, të lutem pra o Zoti i Math, kij mëshire për mua si Perëndi, si mëshirë-plot edhe njeridashës, dhe falma prapë dhëmpshërisht, Parajsën e bekuar.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na përsërite shpirtin, të prishur prej mëkata-ve, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen pesë të Tingëllit edhe tri të Përsëmbëllta të Triodit më T.T.II:

PAS OLIN APOTHEMENI

Jasht' u-dhua ashpërisht, Adam' i mjerë për jetë, nga Parajs' e qiellit, e gënjeu Eva me mollë gjarpëri, dhe i çveshur rri tani, edhe qan përjashta, dhe vajton dhe psherëtin me lot, pra le të sqohemi, dhe le të gati-temi pa pushim, me vrap le të pendohe mi, sipas porrosi-ve të Zotit Krisht: Ti q' u-mishërove, prej Nënës

Virgjëreshë ti na thirr, dhe në Parajsën e Engjëjve, prapë na vëndos me nder.

O Parajs' e nderçime, o bukuri e pashoqe, o pallat i qiellit, o gëzim i Engjëjve dhe Shenjtorëve, ti o drit' e diellit, o banes' e shenjtë, e Profetëve të Drejtëve, nxir zë prej fletëve, edhe oshëti që prej lisave, për faljen e fajtorëve, dhe të mëkatarëve me pendim: Ti q' u-mishërove, prej Nënës Virgjëreshë ti na thirr, dhe në Parajsën e Engjëjve, prapë na vëndos me nder.

Robën që më dhe o Zot, e humba unë i mjeri, kur ta shkela urdhërin, dhe rëmbeva mollen nga dor' e gjarpërit; dhe tani me flet' e fik, edhe me lëkurë, varfërisht i veshur jam si rob, po punonj dhe po dërsinj, për të ngrënë bukën plot me mundim; dhe toka që lëronj me lot, gjëmbe po më sjell e mallkuara: Ti q' u-mishërove, prej Nënës Virgjëreshë ti më thirr, dhe në Parajsën e Engjëjve, prapë më vëndos me nder.

LAVDI, T.T.II. Arriu koha e luftëve shpirtërore, mundja kundër demonëve, përkorja e armatisur plotërisht, bukuria e Engjëjve, kuximi përpara Perëndisë, se me anën e saj Moisiu kuvëndoç me Krijëtarin, dhe ia dëgjoj zërin padukurisht. Me ata vlerësona edhe ne o Zot, të adhurojmë pësimet e tua, dhe Ngjalljen e Shenjtë si njeridashës.

TANI. E përmibekuar je

Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Tingëllit, e Shenjtit të Kishës, pastaj:

SHKURTORJA, T.T.II.

TIS SOFIAS ODHIJE

Ti që prin me urtësi, ti që fal çdo dituri, dhe

mundon të çmëndurit, edhe mpron të varfërit, ndrit-ma dhe forco-ma zëmren o Zoti Krisht. Ti dhuro-ma fjalën, o Fjal' e Perëndisë, që të thërres me zë të math: Kij mëshirë për mua mëkatarin, o Perëndi mëshirëplot.

APOSTULLI

Këndojeni Perëndinë tonë, këndojeni.

Perëndia është i njohur në Jude.

Këndimi prej Letrës së Palit për Romanët.

Vëllezër, tani shpëtimi ynë është më afër se sa e besonim. Nata shkoj, dhe dita u-afrua. Le t'i çveshim, pra, veprat e errësirës, dhe le të veshim armët e dritës. Se ditën do të baresim me nder, jo me dëfrime dhe me dehje, jo me fjetje dhe lavirësira, jo me qarta dhe me nakare. Pra, vishuni me Zotin Jesu Krisht, edhe mos u-kujdesni për dëshirat e trupit. Edhe atë, që është i pafuqishim nga besa, afrojeni, po jo për bisedime të dyshimta. Ay, që beson, le të hanjë nga të gjitha, po ay, që është i pafuqishim, le të hanjë lakra. Ay, që ha, le të mos e përqeshë atë, që nukë ha; dhe ay, që nukë ha, le të mos e gjykonjë atë, që ha, se Perëndia e ka pranuar. Cili je ti, që gjykon një shërbëtor të huaj? Ky qëndron a bie me dorën e të zotit; edhe ka për të qëndruar; se Perëndia ka forcë ta qëndronjë më këmbë.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti tha: Nëqoftëse ua falni fajet njerësve, do tjuua falë fajet Ati juaj qjellor edhe juve. Po nëqoftëse nuk ua falni fajet njerësve, as Ati juaj nukë do tjuua falë fajet. Edhe kur agjëroni, mos u-bëni të mvrojtur si hipokritët, të cilët e prishin fytyrën që tu duken njerësve që agjërojnë. Me të vërtetë po ju them, që e kanë

marrë rogën e tyre plotërisht. Po ti, kur agjëron, lyeji flokët, edhe laje fytyrën, që të mos u dukesh njerësve që agjëron, po tyt-Ati fshehtazi; dhe yt-Atë, që të shikon fshehtazi, do të çpajuanjë faqeza. Mos mblithni thesare mi dhenë, ku krimbi dhe mulica i prishin, dhe kusarët mihin dhe i vjedhin. Po mblithni thesare në qjell, ku as krimbi as mulica nuk i prishin, as kusarët nukë mihin dhe nuk i vjedhin. Se atje, ku është thesari juaj, atje është edhe zëmra juaj.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.

PASDARKA E MADHE

Kjo Shërbesë këndohet mbrëmëne, në periudën e Kreshmëve të Mëdha, të Hënave, të Martave, të Mërkurave, dhe të Enjteve gjer të Martën e Madhe. Passi bekon Prifti, thuhet Trishenti, pastaj:

PSALMI 4

Dëgjo-më kur të thërres o Perëndi i drejtësisë; jam në shtrëngicë të madhe; kij mëshirë për mua dhe dëgjoje lutjen time. O bij të njerësve, gjer kur do ta hithni lavdinë time në baltë? Gjer kur do të doni madhështi dhe grabitje? Mësoni se Zoti e ka shënuar besimin për veten e tij, se Zoti do më dëgjonjë kur ta thërres. Ruaju dhe mos mëkato; këshillohu me zëmërën tënde natën edhe rri urtë; blato therore drejtësie, dhe kij besim më Zotin. Shumë thonë se kush munt të na bënjë nonjë të mirë? O Zot, tregoje dritën e fytyrës sate mi ne, se ti na ke gëzuar zëmërën më tepër se atyre